



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-9249 /2026

Datë: 04.04 /2026

Duke u mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja l) për Vetëqeverisje Lokale Ligjit nr. 03/L-040 ,si dhe në nenin 10, pika 4, dhe nenin 40, pika 11, të Statutit të Komunës së Klinës, të miratuar në mars 2010, me kërkesën e Kryetarit të Komunës, të datës 25.03.2026, me nr. prot. 01Nr.586-8345/2026, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 27.03.2026, mori këtë vendim:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për dhënie donacion të përhershëm të një veture në pronësi të Komunës së Klinës për Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Klinë
2. Vetura e cila jepet donacion ka këto karakteristika:
 - Prodhuesi: Dacia
 - Tipi: SD
 - Viti i prodhimit: 2020
 - Ngjyra: e bardhë
 - Karburanti: benzinë
 - Numri identifikues: UU1B5220X66218728
 - Targat: 03Z-12-08
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Klinës që të nënshkruajë marrëveshjen për dhurimin e automjetit me Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Klinë.
4. Obligohet Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria e Financave që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe procedurale për realizimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- OVL-UÇK- Dega në Klinë
- Zyra për Informim;
- Arkiv



Kryesuesi i Kuvendit
Enyr Berisha